



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 1150/ prot.
2

Pogradec, më 17.03. 2025

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Zn. Mangola Kamolli, KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin dhe relacionet shoqëruese:

**“TRAJTIMIN ME BURSË TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PËR
VITIN SHKOLLOR 2024-2025”**

Me respekt

Kryetari

Ilir XHAKOLLI

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 3 faqe

Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues: 2 faqe

Nr. i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projektvendimin: 2 faqe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. _____ prot.

Pogradec, më ____ . ____ . 2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, Datë ____ . ____ . 2025

PËR

“TRAJTIMIN ME BURSË TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PËR VITIN SHKOLLOR 2024-2025”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 28, pika 4, shkronjat “a”, “b” dhe “d”, të Ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 32, pika 2, të Ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 2, të Ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të Ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të Ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të Ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, nenit 5, ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të policisë së shtetit, të gardës së republikës, të shërbimit të kontrollit të brendshëm, të policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit, të forcave të armatosura, të shërbimit informativ shtetëror dhe të policisë së burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 666 datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, shkresës me nr. 7228/42, datë: 18.11.2024 me lëndë “Dërgohet plani i bursave për nxënësit që ndjekin arsimin me kohë të plotë në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2024-2025.”, me propozim të kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Të trajtohen me bursë nxënësit e arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2024–2025.



Nr.	Emri	Mbiemri	Klasa	Institucioni Arsimor
1	Jurgen	Hoxha	IX	Shkolla 9-vjeçare Ptoleme Xhuvani” Mëmëlisht
2	Ferdinant	Olldashi	III	Shkolla 9-vjeçare “Selim Gjona” Proptisht
3	Megi	Baçi	III	Shkolla 9-vjeçare “Selim Gjona” Proptisht
4	Alkijona	Kume	IV	Shkolla 9-vjeçare “Selim Gjona” Proptisht
5	Ergi	Leka	VIII	Shkolla 9-vjeçare “Selim Gjona” Proptisht
6	Rikela	Kreka	V	Shkolla 9-vjeçare “Selim Gjona” Proptisht
7	Sara	Baçi	IX	Shkolla 9-vjeçare “Selim Gjona” Proptisht
8	Klevis	Kume	I	Shkolla 9-vjeçare “Selim Gjona” Proptisht
9	Elsion	Alinj	I	Shkolla 9-vjeçare “Hamdi Alinj” Leshnicë
10	Neldi	Pengu	VI	Shkolla 9-vjeçare “Hamdi Alinj” Leshnicë
11	Ergys	Hamza	VI	Shkolla 9-vjeçare “Hamdi Alinj” Leshnicë
12	Melisa	Hamza	VII	Shkolla 9-vjeçare “Hamdi Alinj” Leshnicë
13	Damiana	Sofi	VI	Shkolla 9-vjeçare “Dëshmorët e Pojskës” Udënisht
14	Lusia	Fraholli	VII	Shkolla 9-vjeçare “Dëshmorët e Pojskës” Udënisht
15	Anduel	Durollari	VII	Shkolla 9-vjeçare “Dëshmorët e Pojskës” Udënisht
16	Dea	Sallo	III	Shkolla 9-vjeçare “Demokracia” Stropckë
17	Resjon	Shkullaku	III	Shkolla 9-vjeçare “Demokracia” Stropckë
18	Rajan	Çela	II	Shkolla 9-vjeçare “Demokracia” Stropckë
19	Fjona	Sallo	IX	Shkolla 9-vjeçare “Demokracia” Stropckë
20	Ursula	Çela	IX	Shkolla 9-vjeçare “Demokracia” Stropckë
21	Ersida	Kozici	IX	Shkolla 9-vjeçare “Kolë Koci” Pogradec
22	Esi	Maxhari	VII	Shkolla 9-vjeçare “Kolë Koci” Pogradec
23	Ajsel	Ismahilaj	V	Shkolla 9-vjeçare “Kolë Koci” Pogradec
24	Flaina	Oparaku	VI	Shkolla 9-vjeçare “Kolë Koci” Pogradec
25	Noel	Veliu	V	Shkolla 9-vjeçare “Kolë Koci” Pogradec
26	Renis	Spahiu	VI	Shkolla 9-vjeçare “Kolë Koci” Pogradec
27	Angjelo	Buzo	VIII	Shkolla 9-vjeçare “Neim Muçelli” Pretushë
28	Dorida	Beshello	IX	Shkolla 9-vjeçare “Islam Ibi” Çërravë
29	Samuela	Biba	VIII	Shkolla 9-vjeçare “Servet Agolli” Buçimas
30	Ersa	Berberi	III	Shkolla 9-vjeçare “Koli Gusho” Pogradec
31	Florind	Mekolli	IV	Shkolla 9-vjeçare “Koli Gusho” Pogradec
32	Alisia	Haxhi	V	Shkolla 9-vjeçare “Koli Gusho” Pogradec
33	Albisar	Mekolli	VII	Shkolla 9-vjeçare “Koli Gusho” Pogradec
34	Ester	Haxhi	VII	Shkolla 9-vjeçare “Koli Gusho” Pogradec



35	Segi	Hamollari	IX	Shkolla 9-vjeçare “Koli Gusho” Pogradec
36	Gisel	Leka	V	Shkolla 9-vjeçare “Kozma Basho” Pogradec
37	Kledisa	Leka	IV	Shkolla 9-vjeçare “Selim Gjona” Proptisht
38	Enisa	Liçkollari	VIII	Shkolla 9-vjeçare “Shefki Muçllari” Vërdovë
39	Brian	Maxhari	IV	Shkolla 9-vjeçare “Koli Gusho” Pogradec

2. Të trajtohet me bursë nxënësi që frekuenton arsimin parauniversitar në qytet tjetër për vitin shkollor 2024– 2025.

Nr.	Emri	Mbiemri	Klasa	Institucioni Arsimor
1	Arbjol	Torollari	X	Shkolla e Mesme Artistike “Tefta Tashko Koço”

3. Ngarkohet Qendra Arsimore, Bashkia Pogradec, dhe Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financar, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

K R Y E T A R E

Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 1230/Prot
/2

Pogradec, më 17.03.2025

RELACION

Në lidhje me Projekt -Vendimin “Trajtimin me bursë të nxënësve të arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2024-2025”,

E nderuar Kryetare Këshillit!

Të nderuar Këshilltarë!

Për vitin mësimor 2024-2025 për nxënësit e arsimit parauniversitar, Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresën e saj Nr. 7228/42 prot, dt.18.11.2024 i ka akorduar Bashkisë Pogradec planin e bursave.

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 28, pika 4, shkronjat “a”, “b” dhe “d”, të Ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 32, pika 2, të Ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 2, të Ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të Ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të Ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të Ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, nenit 5, ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të policisë së shtetit, të gardës së republikës, të shërbimit të kontrollit të brendshëm, të policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit, të forcave të armatosura, të shërbimit informativ shtetëror dhe të policisë së burgjeve, që

humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 666 datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e-konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, shkresës me nr. 7228/42, datë: 18.11.2024 me lëndë “Dërgohet plani i bursave për nxënësit që ndjekin arsimin me kohë të plotë në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2024-2025” janë akorduar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit **40 (dyzetë)** bursa për shkollat e arsimit parauniversitar.

Përsa i përket shkollave 9-vjeçare të qytetit dhe njërive administrative janë 35 nxënës të cilët plotësojnë kriterin jo ekonomik fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit dhe 4 nxënës që gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë.

Është 1 nxënës i cili plotëson pikën a) të kriterit ekonomik. Ky nxënës studion në shkollën e mesme artistike “Tefta Tashko Koço” në qytetin e Korçës.

Duke ju falenderuar për mbështetjen tuaj, ju ftojme ta votoni propozimin për miratimin e projekt-vendimit “Dhënie burse për nxënësit e arsimit parauniversitar”

Ftojmë Këshilltarët të votojnë këtë Projekt Vendim.

Tëdhënat e Projekt-Vendimit:

Konceptoi: Marsida DERVISHI

Miratoi: Anxhela ANDONI

Konfirmoi: Irsa KARAPANÇA

Dritan BABASULI



KRYETAR

Ilir XHAKOLLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot

Pogradec, më 17.03.2025

RELACION
MBI PROJEKT-VENDIMIN
PËR
“TRAJTIMIN ME BURSË TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PËR
VITIN SHKOLLOR 2024-2025”,

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:

- 1) Akte administrative me karakter normativ
- 2) Akte administrative me karakter individual
- 3) Akte administrative me karakter kolektiv

Sipas përcaktimit të nenit 13 pika 2 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, *“Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.”*

Po kështu, në ligjin 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcakton: *“Akte me karakter normativ” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore”.*

Më tej, ky ligj në nenin 8 shkronja “a” përcakton se është përgjegjësi e Prefektit, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Nga sa më sipër organet përgjegjëse pranë bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të



miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.

Akti nënligjor normativ është një nga mënyrat se si autoritetet e pushtetit shtetëror, të ndryshme nga Kuvendi, rregullojnë me norma me karakter të përgjithshëm çështje të cilat ligji ua ka njohur atyre ushtrimin e pushtetit.

Bazuar në ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, neni 3, pika 2 përcakton si vijon:

“Akt normativ nënligjor” është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij”.

Neni 3 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedures Administrative jep kete perkufizim për 1. “Akti administrativ”:

a) **“Akti administrativ individual”** është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) “Akti administrativ kolektiv” është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Akti normativ përcakton rregulla për një situatë abstrakte dhe që ju drejtohet një numri të pacaktuar subjektsh.

Në rastin e këtij Projekt - Vendimi, gjykojmë se ai është një projekt-vendim i cili plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 1 “a”, të Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, pasi është një akt i nxjerrë nga një organ publik **për interes të një apo më shumë subjektsh të së drejtës të përcaktuar individualisht**, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete dhe që me miratimin e tij do të sjellë pasoja juridike për nxënësit e arsimit parauniversitar, duke i trajtuar me bursa, për vitin shkollor 2024 – 2025.

Përfundimisht konkludojmë se: Akti administrativ është i natyrës individuale dhe si i tillë nuk kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti Qarkut Korçë, sipas ligjit.

Propozoi dhe interpretoi karakterin e aktit juridik: K.TANE

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI